



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	20/DPK
Dep.	
Nr. I faq.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot.	01-2692/14
Br. Prot.	
Prot No.	
Data	
Datum	
Date	21.07.2014
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.07.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbylllet rasti me nr. AKK – 03-2004/14, për z. Shpejtim Gacaferi – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Junikut, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, mirëpo mund të ketë konflikt rast për rast të interesit, i cili duhet të deklarohet kur ai paraqitet.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-2004/14, për z. Shpejtim Gacaferi – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “Juniku i Ri” SH.A., është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (më tutje LPKI).**

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Gacaferi, së pari është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas kësaj, zyrtari në fjalë, është kontakuar nga zyrtarët e Agjencisë me ç ‘rast është diskutuar lidhur me dyshimin për situatën në të cilën ndodhet për të parandaluar situatën e mundshme e konfliktit të interesit.

z. Gacaferi ka konfirmuar se është pronar në biznesin “Juniku i Ri” mirëpo ai ka thënë se funksionin e Drejtorisë në këtë biznes e ushtron dikush tjetër.

Pas kësaj Agjencia ka kontaktuar zyrtaret e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të cilët kanë konfirmuar një gjë të tillë.

Duke pasur parasysh këto të dhëna konstatojmë se në këtë situatë nuk nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Mirëpo, meqenëse sipas LPKI të qenurit pronar në biznese private nuk është kufizim i natyrës “absolute” që lidhet me funksionin e zyrtarit, atëherë z. Gacaferi, ashtu siç është njofuar edhe më herët, duhet të deklaroj konfliktin “rast për rast” të interesave private, në rastet kur ai ka rol përcaktues në ndonjë vendimmarrje konkrete.

Rastet dhe mënyra e deklarimit janë të përcaktuara në nenin 13 të LPKI. Pika 1 e këtij neni përcakton se “*çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak përlindjen e një konflikti të interesit*”.

Ndërsa pikat 2 dhe 3 përcaktojnë mënyren e deklarimit “rast pë rast” të konfliktit të interesave private:

- 2 *Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur.*
- 3 *Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje përlindjen e një konflikti të interesit.*

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorisë të DPK- së;
- Z./z. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Hasan Preteni

